



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**KËSHILLI I QARKUT SHKODËR
KRYETARI**

Nr. 523/2 Prot.

Shkodër, më 09.07.2026

V E N D I M


Nr. 17, Datë 07.07.2026

« Mbi disa ndryshime për prioritetet e Këshillit të Qarkut Shkodër »

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e datës **07.07.2026**, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, bazuar në nenin 77, 78,83 të Ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, paragrafi 130 i Udhëzimit nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit, bazuar në Vendimin e Këshillit të Qarkut Shkodër nr.52 datë 23.12.2016 "Mbi prioritetet e KQSH" dhe VKQShkodër nr. 20, datë 26.05.2017 i ndryshuar me shtesat ndër vite, bazuar në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, bazuar në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relatimit nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit dhe pas diskutimit nga anëtarët e keshillit, u kalua në procesin e votimit ku u **miratua** me **13 Vota Pro, 0 Vota Kundër dhe 0 Vota Abstenim**;


VENDOSI:

1. Në vijim të pikës 1.1 të VKQ Shkodër nr.20, datë 26.05.2017, të miratojë investimet prioritare si më poshtë;
 - 1.a- "Rikualifikim urban të hapësirave publike Pallati Nr. 103 dhe Sistemim, Asfaltim e Ndriçim i rrugës Lagjia Nushaj (Segmenti I)".
2. Këto investime do jenë pjesë e buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2026 dhe PBA-së 2027-2029, pas nënshkrimit të marrëveshjes mes dy njësive të vetëqeverisjes vendore, si investime prioritare të Bashkisë Fushë Arrëz.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.





REPUBLIKA E SHQIPËRISE



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR RELACION

09.07.2026

LËNDA: « Mbi disa ndryshime mbi prioritetet e Këshillit të Qarkut Shkodër »

Këshilli i Qarkut Shkodër duke pasur prioritet harmonizimin e politikave të zhvillimit rajonal e konsideron të rëndësishëm të kontribuojë në rehabilitimin e infrastrukturës ndër komunale. Këshilli i Qarkut Shkodër në objektivat e tij ka konsideruar dhe konsideron të rëndësishme zhvillimin ekonomik të zonave të territorit duke lehtësuar banoret e saj për të pasur akses në tregun rajonal të produkteve si dhe në tregun e punës.

Koncepti Strategjik i Zhvillimit Rajonal të Qarkut Shkodër në masat e saj për Infrastrukturën dhe Shërbimet, Turizmi dhe Bujqësinë parashikojnë rehabilitimin e rrugëve ndër-komunale për të pasur akses në tregun e rajonal me produktet tipike të zonës. Gjithashtu në dokumentin strategjik të rishikuar “Skenarët e Zhvillimit Nënrajonal të Qarkut Shkodër” në masat dhe nënmasat e tij parashikohen projekte që kanë për qëllim përmirësimin e projekteve dhe infrastrukturës ndërvendore.

A.- Investimi; Rikualifikim urban i hapsirave publike Pallati Nr.103 dhe Sistemim, Asfaltim, Ndriçim i rrugës Lagja Nushaj (Segmenti I) Bashkia Fushë Arrëz“

Në kuadër të mbështetjes së investimeve që kontribuojnë në përmirësimin e infrastrukturës publike dhe cilësisë së jetesës së komuniteteve në territorin e Qarkut Shkodër, Bashkia Fushë-Arrëz ka paraqitur kërkesë për bashkëfinancimin e projektit me objekt **“Rikualifikim urban të hapësirave publike Pallati Nr. 103 dhe Sistemim, Asfaltim e Ndriçim i rrugës Lagja Nushaj (Segmenti I)”**, me vlerë 7,500,000 lekë, ndërsa bashkia do të mbulojë me fondet e saj shërbimet e mbikëqyrjes dhe kolaudimit.

Projekti përfshin rikualifikimin e një hapësire publike prej rreth 250 m² pranë Pallatit Nr. 103 në qytetin e Fushë-Arrëzit, ku parashikohen punime sistemimi, shtrim me pllaka guri, vendosje stolash dhe ndriçim publik, duke krijuar një mjedis më funksional dhe estetik për komunitetin.

Projekti përfshin rikualifikimin e një hapësire publike prej rreth 250 m² pranë Pallatit Nr. 103 në qytetin e Fushë-Arrëzit, ku parashikohen punime sistemimi, shtrim me pllaka guri, vendosje stolash dhe ndriçim publik, duke krijuar një mjedis më funksional dhe estetik për komunitetin. Nga kjo ndërhyrje përfitojnë drejtpërdrejt rreth 60 familje dhe aktivitetet ekonomike të zonës. Gjithashtu, projekti parashikon sistemimin dhe asfaltimin e segmentit të parë të rrugës së Lagjes Nushaj, me gjatësi rreth 200 m, e cila shërben për mbi 30 banesa. Punimet përfshijnë zgjerimin dhe asfaltimin e rrugës, sistemimin e ujërave sipërfaqësore, ndërtimin e trotuarit, mureve mbrojtëse, ndriçimit publik dhe elementëve të gjelbërimit.

Investimi është në përputhje me prioritetet e zhvillimit të Qarkut Shkodër për përmirësimin e infrastrukturës publike, rehabilitimin e hapësirave urbane dhe rritjen e aksesueshmërisë për qytetarët. Duke pasur parasysh ndikimin e drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe faktin se projekti është pjesë e prioritetëve të Bashkisë Fushë-Arrëz për vitin 2026 dhe në vijim, vlerësohet se ai paraqet interes publik dhe mund të merret në konsideratë për mbështetje financiare nga Këshilli i Qarkut Shkodër.

